



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 68, QARKU KORÇË,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 68, Qarku Korçë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", ", nenin 93 dhe 94, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.1561 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Korçë, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Korçë që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për shtatë (7) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Korçë, me shkresën nr. 2491 prot., datë 23.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për secilën nga VNV-të e Qarkut Korçë.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 68, Qarku Korçë, është:



Nr. 369 i Vendimit Data 15.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.68, Qarku Korçë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

1. Palestra e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Dhimitraq Gjata", me sipërfaqe prej 300 m², Bashkia Maliq;

Palestra e Shkollës së mesme të Bashkuar "Dhimitraq Gjata" propozohet për herë të parë për caktimin e VNV. Palestra është ambjent i ri i ndërtuar pranë Shkollës në Bashkinë Maliq. Në zgjedhjet e 2017 VNV nr.68 ka qënë e caktuar në palestrën e Shkolles së Mesme të Bashkuar "Raqi Qirinxhi" me vendndodhje në Bashkinë e Korçës.

Ambienti i propozuar ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 68, në Palestrën e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Dhimitraq Gjata", me sipërfaqe prej 300 m², Bashkia Maliq.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

